



# MUSINE KOKALARI

*dhe*

## SOCIAL - DEMOKRACIA NË SHQIPËRI

Alina Wagner

FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG

**MUSINE KOKALARI**  
**dhe**  
**Social – Demokracia në Shqipëri**

**FRIEDRICH  
EBERT   
STIFTUNG**

Tiranë, 2016  
Alina Wagner

Botimi u mundësua nga:  
Fondacioni “Friedrich Ebert”

Zyra e Tiranës  
Rr. „Abdi Toptani“, Torre Drin, Kati 3-të, Kutia Postare 1418  
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 04 2250986 / 04 2273306: Fax: +355 04 22622067  
[www.fes-tirana.org](http://www.fes-tirana.org)

Viti i Botimit: 2016  
Përpunimi grafik dhe shtyp: Albdesign PSP  
ISBN: 978-9928-215-08-6

Autor: Alina Warner

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

## Shkurtime

Akronime:

PK

Partia Komuniste

FNÇ

Fronti Nacional Çlirimtar

LSI

Lëvizja Socialiste për Integrim

PSDSH

Partia Social Demokrate e Shqipërisë



## Përmbajtja

1. Rreth Demokracisë Sociale.....	8
2. Themelimi i Partisë Social-Demokrate të Shqipërisë.....	9
3. Programi i Partisë Social Demokrate.....	11
4. Shënim për Aleatët.....	12
5. Impakti i Kokalarit në Kulturën Politike dhe Sociale Shqiptare:.....	13
A është Social-Demokracia ende prezente apo e mundshme?	
6. Referencat.....	18
7. Apendix.....	21
• Programi me dhjetë pika i Organizatës Kombëtare “Balli Kombëtar”	
• Memorandumi i Unionit Demokratik drejtuar Aleatëve	
• Programi i Partisë Social Demokrate	
• Fragment nga gjyqi i Kokalarit	



## Hyrje

Po të përpiqesh të listosh ecurinë historike të lëvizjes Social – Demokrate në shtetet evropiane, ka shumë gjasa që Shqipëria të renditet në fund të listës. Ky supozim nuk është i çuditshëm, pasi zhvillimet social-ekonomike e politike, si dhe personaliteti i spikatur i udhëheqësve politikë, u japin shkëlqim partive të tyre. Pra, është e kuptueshme që emra si Friedrich Ebert, Willy Brand, Olof Palme dhe Helmut Schmidt peshojnë shumë më tepër në historinë e Social – Demokracisë sesa emri i Musine Kokalarit. Ky disnivel vlerësues nuk është rrjedhojë e intelektit modest, e moshës apo faktit që ajo ishte një grua, por përcaktohet prej mjedisit shtypës, që i godet idetë e reja në gjenezë.

Ideatore dhe nismëtare për të themeluar Partinë Social Demokrate Shqiptare në 1943, Musine u arrestua tre vjet më pas për pikëpamjet e saj politike dhe u dënua me 30 vjet burgim, prej të cilave ajo kreu vetëm 16. Musine Kokalari mbetet një nga shkrimtarët më të shquara dhe të rëndësishme në vendin e vet, gruaja e pare, botimet e së cilës u publikuan në Shqipëri dhe një simbol tipik i represionit të regjimit të Enver Hoxhës.

Deri më tani, pak është botuar (në gjuhën Angleze, apo ndonjë tjetër) për angazhimin politik të Musine Kokalarit, duke e limituar Demokracinë Sociale në një fenomen dukshëm vetëm Evropian-Perëndimor deri në dekadat e fundit të shek. XX. Fillimet e idealeve social-demokrate ishin gjithashtu prezente edhe gjatë shekullit të kaluar në Shqipëri, por, sërish demokracia në përgjithësi ka kaluar në rrugë të mundimshme të historisë për shkak të mjedisit autokratik në vend. Në retrospektivë, duket se është i pashmangshëm dështimi i Musine Kokalarit dhe mbështetësve rreth saj. Gjithsesi, bazuar në historinë e dhënë të Social-Demokracisë në Shqipëri, shtrohet problem: është mësuar gjë prej kësaj?! A është Social-Demokracia ende e pranishme në Shqipëri?!

Në përpjekje për të zgjeruar kuptimin dhe perceptimin e Social - Demokracisë, është e rëndësishme të hedhim dritë mbi përpjekjet “e dështuara”. Ky punim përpiqet, kryesisht, të japë të dhëna mbi prirjet e Social-Demokracisë në Shqipëri, duke theksuar dhe nënvizuar përpjekjet e Musine Kokalarit për pluralizmin. Dhe, në radhë të dytë, synon të shërbejë si një kujtesë, jo vetëm mbi mizorinë e regjimit komunist, por dhe mbi nevojën për të



pasur një diskurs të vazhdueshëm rreth çështjeve historike dhe politike të akumuluar në dekada.

Kompleksiteti i dhënë, si dhe thellësia e çështjes për të mbuluar temën në tërësinë e saj, është përtej qëllimit të këtij punimi. Për këtë arsye, ky punim nuk do të thellohet në detaje mbi jetën personale dhe akademike të Kokalarit dhe as nuk do të ofrojë një kuptim tërësor mbi ideologjinë dhe historinë e Demokracisë Sociale. Ndaj fokusi do të mbetet në faktet historike (kryesisht të mara nga esetë e Kokalarit), që çuan në formimin e Partisë dhe në ato çka kanë mbetur ende nga Social-Demokracia në ditët tona.

Pjesa e parë e këtij punimi do të ofrojë një përcaktim të shkurtër se çfarë është Social-Demokracia dhe, më pas, do të trajtojë sfondin historik mbi themelimin e Partisë Shqiptare Social-Demokrate. Mbështetur në këto pikëpamje, kapitulli final *“Impakti i Kokalarit në Kulturën Politike dhe Sociale: A është Demokracia Sociale ende prezente apo e mundshme?”* do të konkludojë me disa mendime mbi prezencën në ditët tona të Demokracisë Sociale në Shqipëri.

## 1. Rreth Social - Demokracisë

Përmes raportimeve të lajmeve mbi “krizën e Social - Demokracisë në Evropë” apo mbi ish kandidatën e Partisë Demokratike, Bernie Sanders, në zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara, publikut i janë dhënë disa terma teknikë dhe fjalë, me të cilat ata mund të jenë të pa-familjarizuar. Në thelb, termi Social - Demokraci nuk është i panjohur, por për shak se mbulimi i saj në media në Evropë apo SHBA rritet vazhdimisht, bëhet i nevojshëm shpjegimi se çfarë është Social - Demokracia.

Temri “demokraci” përbën thelbin, pasi në shekullin e 19-të dhe të 20-të socialistët filluan ta kategorizonin veten si “social demokratë” në mënyrë që të diferencoheshin nga socialistët e tjerë, që kundërshtonin demokracinë (Cf. Berman 2005:3).

Sipas Enciklopedisë Britanike, që gjendet në internet, Social - Demokracia është përcaktuar si më poshtë:

“Social - Demokracia, [a] ideologji politike, që promovon një tranzicion të paqtë të zhvillimit të shoqërive nga kapitalizmi në socializëm, duke përdorur mënyra të qendrueshme politike. Bazuar në socializmin e shekullit të 19-të dhe të parimeve të Karl Marx dhe Friedrich Engels, social -

demokracia ndan rrënjë të përbashkëta ideologjike me komunizmin, por shmang militantizmin dhe totalitarizmin. Social - Demokracia është njohur, fillimisht, si revizionizëm, pasi përfaqësonte një ndryshim bazik të doktrinës marksiste, kryesisht në mohimin e revolucionit për themelimin e shoqërive socialiste. Duke e copëzuar në mënyrën më të thjeshtë përcaktimin, dikush mund ta përshkruajë atë si një kompromis mes Socializmit dhe Kapitalizmit. Në këtë aspekt, siç shkruan një dijetar modern, “social demokratët janë socialistët pa kurrajo bindjesh revolucionare apo socialistë, të cilët kanë zgjedhur fletët e votimit mbi plumbat (ballots over bullets) (Berman 2005:3).”

## 2. Themelimi i Partisë Social Demokrate të Shqipërisë

Në vitin 1972, Kokalari përfundoi së shkruari librin e saj “Si lindi Partia Social-Demokrate”, një shpjegim personal mbi themelimin e partisë dhe të njerëzve të përfshirë.

Informacioni lidhur me rrënjët e Social - Demokracisë në Shqipëri është i pa mjaftueshëm, i limituar dhe, deri më sot, gjerësisht i debatuar. Kjo nuk përbën ndonjë surprizë, pasi, historikisht, Shqipëria nuk ka shumë përvojë lidhur me të. Në ndryshim nga Gjermania, Shqipëria nuk e pati përvojën e lëvizjes së punëtorëve apo krijimin e sindikatave dhe vështirë se ka njohur zhvillimet dhe rrjedhojat e revolucioneve të 1848/49 në Perëndim, që mundësuan principe të forta teorike për Evropën (Cf. Potthoff and Miller 2006:5). Por, gjithsesi, Shqipëria gati njëqind vjet më pas, nuk ishte dhe aq e izoluar dhe e pandikuar nga këto lëvizje. Kur Kokalari themeloi partinë në 1943, Shqipëria ishte përballur me zhvillime të shumta kombëtare. Mbështetur në kujtimet e shkrimtarëve, periudha e Rilindjes ishte aktive, kur Italianët fashistë pushtuan Shqipërinë, në 1939. Rilindja Kombëtare, që daton prej 1870 e deri në deklarin e Pavarësisë në 1912, rezultonte në një forcim të identitetit Shqiptar (në aspektin kulturor, politik dhe social). Lëvizja kombëtare erdhi relativisht vonë për Shqipërinë edhe duke e krahasuar me vendet e tjerë ballkanikë në shekullin e 19-të.

Së bashku me ndërtimin e kombit, që korrelohet ngushtësisht me punën intelektuale të vëllezërve Frashëri, Revolucionin i Tetorit në Rusi i la shenjat e saj edhe në Shqipëri: “[...] *Grupe komuniste qarkullojnë sa këndeje andej, edhe pse jo në çdo vend të Shqipërisë, të cilët aderojnë principe që janë të*

*paqarta dhe jo uniforme* (Kokalari 1972).”

Për më tepër, në një kohë jo shumë të afërt, u krijua dhe Partia Komuniste (PK). Në fakt, Shqipëria ishte i vetmi vend në Ballkan pa një parti të tillë në fillimet e 1920-ës. Partia e parë Komuniste u formua ligjërisht në Bashkimin Sovjetik në 1928-ën, ndërkohë që në Shqipëri, PK u themelua shumë më pas, në vitin 1941, me Enver Hoxhën si Sekretar i Partisë.

Musine Kokalari dhe Enver Hoxha janë me origjinë qytetare të njejtë, madje, nga e njëjta familje dhe janë kushurinjtë relativisht të afërt. Shtëpitë e tyre të fëmijërisë në Gjirokastrë janë vetëm pesë minuta distancë në ecje larg nga njëra tjetra. E lindur në 1917-ën në Adana (Turqi) nga prindër me origjinë gjirokastroje, Kokalari tregoi shumë shpejt pasionin e saj për të shkruar. Në 1938 ajo u largua për në Itali për të studiuar letërsi në Romë, ku dhe u diplomua në vitin 1941. Një vit më pas ajo i'u bashkangjiti lëvizjes antifashiste dhe antikomuniste në Romë e, më pas, në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë (Zhiti 2012).

Pak kohë pas themelimit të Frontit Nacional Çlirimtar (FNÇ)- një organizatë rezistente, që luftonte kundër pushtimit Italian në Shqipëri – u krijua lëvizja e rezistencës antikomuniste, Balli Kombëtar, një organizatë heterogjene njerëzish me pikëpamje të ndryshme politike dhe me një platformë pak a shumë demokratike, që e konsideronin veten si patriotë të thjeshtë (Kokalari 1972).

Për të unifikuar FNÇ dhe Ballin Kombëtar, Kokalari u propozua t'i bashkangjitej Frontit Nacional Çlirimtar jo si një individ, por si pjesë e një grupimi demokrat, apo më mirë të themi, si një parti. Duke i afruar të dyja lëvizjet dhe duke formuar një union bazë demokratik, ata do të mund të ishin të aftë të luftonin kundër pushtuesve më intensivisht (Ibid.). Gjithësesi, çështja kryesore ishte që Partia Social - Demokrate të shërbente si “një rrugë e mesme” për të tërhequr forcat e pavendosura (Ibid.). Për shkak të kundërshtive me gruan e ardhshme të Enver Hoxhës (Nexhmije Xhuglini), Kokalari u largua nga FNÇ dhe u përpoq të rivendoste idenë e Partisë së Social - Demokrate me njerëz të tjerë.

Në 1942 Kokalari u ndesh me juristin Skënder Muço, mësuesin e letërsisë Isuf Luzaj dhe gjuhëtarin Selman Riza, të cilët ndanin vlera të njëjta me ato të Kokalarit. Muço, si dhe të tjerët, ishin të shqetësuar për drejtimin

që po merte lufta. Pas kontraditave me gruan e ardhshme të diktatorit, Musine sërisht propozoi idenë e saj të formimit të koalicionit demokratik i cili mbështetej në dhjetë pika programore dhe në të njëjtën linjë me Ballin Kombëtar (Appendix 1).

Grupi më pas publikoi një broshurë, duke shpallur përmes saj krijimin e partisë (Ibid.). Kjo përpjekje (ndoshta ashtu siç pritej), ishte e destinuar të dështonte sepse, nga njëra anë, Muço dhe Luzaj patën një luftë pushteti, se kush do të drejtonte grupin dhe, nga ana tjetër, drejtuesit e Ballit Kombëtar nuk ishin të interesuar për demokracinë dhe donin të vazhdonin kursin e tyre si më parë: *“Alternativa Demokratike ndodhej në një moment tragjik, si zakonisht, e kapur mes Komunistave, nga njëra anë, dhe liderëve të Ballit Kombëtar nga ana tjetër, të cilët përpiqeshin me influencat e tyre personale të mbanin pushtetin për veten e tyre. Një moment tragjik (Ibid.).”*

Gjithsesi, grupi arriti të publikojë gazetën e quajtur “Zëri i lirisë”, që korrelonte me partinë e tyre e Musine Kokalarin si forcë shtytëse e saj.

### 3. Një program i Partisë Social – Demokrate

Në gazetë, në Shkurt të 1944, Musine publikoi programin e Partisë Social - Demokrate (Appendix 2). Sipas programit, partia kërkonte liri politike, e cila siguronte të drejtën e çdo qytetari për praktikimin e lirisë së shprehjes, të lirisë e shtypit dhe të lirisë së votës: *“Arsyeja kryesore e kufizimit të lirisë politike është [mungesa e] drejtësia sociale (Kokalari 1944).”* Për t’u theksuar është fakti se Kokalari mbështet idenë e një konfederate Ballkanike, e cila u shfaq në fillimin e shekullit të 20-të nga shumica e partive Social-Demokrate të gadishullit Ballkanik.

Përveç faktit se Programi i Partisë përfaqëson shumë më tepër se një prezantim të thjeshtë të objektivave të saj, ai, gjithashtu, thekson në vetvete katër element të demokracisë:

- Një sistem politik për zgjedhjen dhe zëvendësimin e qeverisjes përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.
- Pjesëmarrje aktive e njerëzve si qytetarë, në jetën politike dhe civile.
- Mbrojtje të të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët.
- Ligjin e së drejtës, në të cilin ligjet dhe procedurat aplikohen njësoj për të gjithë qytetarët (Cf. Hilla Leksione te Universitetit 2004).

Përveç faktit se ata arritën të publikonin gjashtë çështje në gazetë, Kokalari gjithsesi, e dyshonte suksesin. Njerëzit, që qëndronin mbrapa botimeve në gazetë (Kokalari, Muço, Luzaj dhe Riza), nuk u takuan kurrë më pas. Juristi Skënder Muço u ekzekutua nga trupat Gjermane në 1944-ën. Brenda familjes Kokalari (dhe të Hoxhajve) u persekutuan 14 anëtarë. Dy nga vëllezërit e saj u arrestuan dhe, më pas, u vranë nga të ashtëquajturit “ushtarët e lirisë”. Një ditë më pas, vetë Kokalari u kap dhe u mor në pyetje. Në nëntor të të njëjtit vit, ajo u lirua dhe u bë dëshmitare e çlirimit të Shqipërisë.

Sipas Kokalarit ky moment i dha fund dhe periudhës së rilindjes *“dhe për-pjekjes për demokraci nga individë që dëshironin të mbronin të varfërit: të mbronin punëtorët nga skllavëria fizike dhe intelektuale: të mbronin dinjitetin e tyre human (Ibid.)”* si rrjedhojë, diktatura e komunizmit filloi dhe njerëzit, që guxuan të shqiptonin dëshirat e tyre për pluralizëm politik, shumë shpejt u përballën me burgim apo me vdekje.

#### 4. Një shënim për Aleatët

Si rrjedhojë e luftës, në Nëntor 1945, misionet Britanike, Amerikane, Franceze, Jugosllave dhe Sovjetike ishin ende aktive në Shqipëri. Në verën e 1945-ës u përgatit Kushtetuta e re e Shqipërisë, që ishte thjesht një kopje e asaj Jugosllave (Cf. Viskers 2014:155). Ndërkohë që qeveria e re kërkonte njohjen e saj, perëndimorët kërkonin zgjedhje demokratike. Rreth kësaj kohe, Musine u terhoq pak a shumë nga angazhimi politik dhe punoi në librarinë e saj në Tiranë.

Ndërkohë kishte diskutime për zgjedhjet, që do të bëheshin në 2 Dhjetor 1945. Në të njëjtin vit, Shaban Balla, një figurë aktive e rilindjes, vizitoi disa herë Musine Kokalarin për t’i shpjeguar se ata duhej të bënin diçka dhe të ndihmonin britanikët. Si fillim, Kokalari nuk ishte e interesuar, pasi mund të ishte shumë afër riburgimit dhe nuk donte të përfshihej në aktivitetet e të tjerëve, dhe, mbi të gjitha jo në mënyrë jolegale (Cf. Kokalari 1972). Gjithsesi, ajo ra dakort për t’ju kërkuar me shkrim aleatëve një mbështetje morale, në mënyrë që të shtyheshin zgjedhjet me qëllim që parti të tjera të mund të krijoheshin dhe të ishin pjesë e tyre, duke inicuar një qeverisje pluraliste: *„Ne kishim pak shpresë, por gjithsesi diçka duhej bërë. Unë i qëndroj*

*asaj që kam thënë dhe nuk kërkoj të gjej së çfarë interesash kanë grupime të tjera. Unë mbajta distancë nga njerëz dhe grupet e tjera dhe shpreha vetëm një ide timen mbi Shënimin që më ishte kërkuar (Ibid.).“*

Në takimin e mbajtur në Nëntor 1945, Musine përpiloi një Shënim (Apendix 3), duke shpjeguar situatën aktuale në Shqipëri dhe duke propozuar shtyrjen e zgjedhjeve në mënyrë që parti të ndryshme politike të merrnin pjesë në to. Mes njerëzve që firmosën Shenimin ishin katër monarkistë (njerëz që mbështetnin Mbretin Zog), katër njerëz të rilindjes, një mik i Kokalarit me orientim social-demokrat dhe vetë Musine. Më pas Balla u dorëzoi amerikanëve dhe britanikëve kopje të Shënimit (Ibid.).

Gjithësesi Aleatët nuk i ndërhyjnë qeverisë dhe heshtën mbi një çështje, e cila, logjikisht, rezultoi më pas si e pashmangëshme për dënimin e firmosësve. Një nga një firmëtarët u arrestua me akuzën për rrëzim të qeverisë. Pasojat për të gjithë këta njerëz janë thjeshtësisht të imagjinueshme: disa u pushkatuan (mes tyre dhe Shaban Balla), shumica prej tyre u burgosën. Në gjyq, duke mbrojtur pozicionin e saj deri në fund (edhe pse fati që tashmë i vulosur), Musine i pranoi ndryshimet në lidhje me qeverinë (Apendix 4). Kokalari u dënua me 30 vjet burgim, të cilat më pas u reduktuan në 20-të nga të cilat ajo bëri 16 (Zhiti 2012).

E sëmurë rëndë me kancer të gjirit në vitet e fundit, Kokalarit i'u mohua trajtimi në një spital lokal. Ajo vdiq në izolim të plotë në 1983-in. Pavarësisht persekutimit me të cilin ajo u përball gjatë jetës së saj, funerali i saj ishte më tragjik. Arkivoli u bë me mbetjet e mbledhura nëpër kantierët e ndërtimeve dhe u punua nga një oficer sigurie i rajonit i cili u këshillua t'i lidhë duart trupit të vdekur (Ibid.).

## 5. Impakti i Kokalarit në Kulturën Politike dhe Sociale në Shqipëri: A është Demokracia Sociale ende prezente apo e mundshme?!

Sot Shqipëria nuk ka shumë lidhje me Demokracinë (Sociale) dhe kjo vjen si pasojë e shumë faktorëve.

Është i diskutueshëm fakti nëse Musine Kokalari ka pasur një impakt në historinë e Shqipërisë. Kryesisht ajo kujtohet si një viktimë e regjimit komunist dhe një tregimtare e talentuar. Për publikun e gjerë, formimi i Partisë Social-Demokrate në vitin 1943 mbetet pak a shumë i panjohur. A lanë gjurmë për-

pjekjet e Kokalarit në jetën politike dhe sociale të Shqipërisë së sotme? Nuk është i pavend perceptimi se në Shqipëri nuk ka shumë diferencë mes të qenit “socialist” apo “demokrat”. Edhe para se të fillojmë të flasim për format e ndryshme të demokracisë, demokracia në vetvete është një koncept që duhet diskutuar. Këto nuanca të vetë-përcaktimit politik, që sot janë shumë të natyrshme në Evropën e Madhe, përbëjnë një luks, që nuk mund të gjendet në Shqipëri. Gjatë kërkimit për këtë punim dhe një përcaktimi mbi demokracinë sociale, burimet ishin shumë të kufizuara. Në fakt ka vetëm një përcaktim në gjuhën shqipe, i mundësuar nga Fondacioni Friedrich Ebert, i cili është i lidhur ngushtësisht me partinë Social Demokrate Gjermane. Një shqiptar i zakonshëm nuk mund të konsultohet as më artikujt e Wikipedia në gjuhën shqipe rreth social - demokracisë, edhe pse në Shqipëri ekzistojnë dy parti, të cilat kanë një orientim social - demokrat.

Në 1991, Skënder Gjinushi, një ish anëtar i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe ish ministri i saj, themeloi Partinë Social - Demokrate (PSD), e cila kishte deputetë në parlamentin shqiptar në vitet 1992 – 1996-të dhe, më pas, prej viteve 1997 – 2009 (Cf. Nohlen and Stöver 2010:140-142). Në fakt, partia mban të njëjtin emër me atë të Kokalarit dhe bashkëpunon shumë ngushtë me Partinë Socialiste të Shqipërisë (“Socialistë të reformuar” – siç e quajnë ata veten) me të cilët ata ndërtuan koalicionin përmes aktivitetit parlamentar. Tashmë PSD është pothuajse e papërfillur në politikën Shqiptare.

Rëndësi të madhe gjatë kësaj kohe ka marrë vetëm Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), një parti që përfaqëson në mënyrë të moderuar “rrugën e tretë” mes dy partive kryesore (Partisë Socialiste dhe Partisë Demokrate) në Shqipëri. LSI vjen si rezultat i polemikave të brendshme të partisë mes kryetarit të LSI, Ilir Meta dhe liderit të asaj kohe të Partisë Socialiste, Fatos Nano. Partia e Metës thekson natyrën e saj jo-ideologjike edhe pse baza teorike tërhiqet drejt qendrës së majtë (psh; partia mbështet modelin e mirëqënies sociale Evropiane) (Cf. Barbullushi 2014:88-89).

Në Shqipëri, terreni politik aktual kërkon me ngulm një strukturë të vërtetë (social) demokratike. Duke diskutuar “mbetjet” e Social - Demokracisë në skenën politike Shqiptare, është e nevojshme të konsiderojmë si më poshtë: Në vend “të mbetjeve” do të ishte më mirë të kishim në radhë të parë “ushqim”. Stukturat Social – Demokrate, siç i njohim ne nga Bashkimi Evropian, mund të gjurmohen nëpërmjet zhvillimeve të shumta. Në shekujt e 18-të

dhe 19-të Evropa kaloi nëpërmjet një zhvillimi të madh social, kulturor, politik dhe teknologjik, që formuan shtetet e tyre dhe karakteristikat kombëtare. Peridha e Iluminimit, që e riorientoi filozofinë perëndimore, politiken dhe shkencën në kërkim të vlerave dhe kthimi të racionalizmi janë pararendëse të modernizmit të shekullit të 20-të (Cf. Stanford Enciklopedia e Filozofisë 2010). Me një rëndësi të ngjashme apo, ndoshta dhe më të madhe, ishte Revolucioni Industrial që lejoi një fermer të thjeshtë të heqë dorë nga bagëtitë e tij e të kërkonte mundësi punësimi gjetkë. Formimi i sindikatave gjatë kësaj periudhe është një faktor i rëndësishëm, që kontribuoi, në krijimin e ideologjisë së social demokracisë. Si rezultat, ndryshimi social ekonomik i Kontinentit dhe periudha e Industrializimit sollën teori kritike, ku, mbi të gjithë dhe më radikali ishte marksizmi. Në kontrast me këto zhvillime, Shqipëria më në fund u “zgjua” nga një gjumë i gjatë në fund të shekullit të 19-të, duke goditur sundimin e Perandorisë Otomane (për pothuajse 500 vjet).

Kriticizmi mbi mugesën e strukturave social-demokrate në Shqipëri nuk është tërësisht i drejtë. Le të marrim parasysh këtë: të imagjinojmë sikur njerëzit në Bashkimin Sovjetik nuk do të kishin dëgjuar kurrë për marksizmin, por do të kishin jetuar me të. Duke e transferuar këtë shembull në rastin e Shqipërisë, do të theksonim se historia e Shqipërisë karakterizohet nga “importi” i regjimeve dhe ideologjive të sforcuara. Sigurisht, Republika e Shqipërisë ka jetuar nën një qeverisje komuniste. Realiteti, gjithësesi, provon se ata kanë jetuar nën diktaturën e maskuar si socializëm (pothuajse si të gjitha vendet ish komuniste).

Mungesa e entuziazmit për bashkëpunim është një nga faktorët, që do të pengojnë zhvillimin e Shqipërisë drejt një shoqërie të lartësuar mendërisht për një kohë të gjatë. Por një gjë duket: opinionet marrin rrugë më shpejt se sa faktet në kulturën shqiptare. Të marrësh një opinion të balancuar për socializmin dhe ideologjinë e tij do të dukej e pazakontë. Burime të besueshme sugjerojnë se, cilado forcë politike që do të jetë në fuqi në Shqipëri, do të krijojë pengesa në mënyrë që të shmangen hapjet e dosjeve sekrete të policisë apo që janë objekt i diskutimit të krimeve komuniste, me frikën e nxjerrjes në pah të figurave të ndryshme politike.<sup>1</sup> Problemi është i tillë: nëse shoqëria shqiptare nuk merr informacion mbi subjektet apo është më

<sup>1</sup> Në mënyrë që të ruajmë burimin, po e lëmë anonim.



komfort me lënien e dhimbjes pas, ata do të ballafaqohen me rrishtun e brendësimit dhe riprodhimin të kredove të vjetra që janë ende evidente në shumë institucione rreth e qark vendit. Nëse ka diçka që ka lënë pas komunizmin në Shqipëri, ai është pikërisht pakënaqësia me komunizmin.

Ka disa faktorë që janë lënë të papërcaktuar në këtë punim, që e bënë atë çka është shkruar më sipër vetëm një pjesë të vogël të realitetit. Jo vetëm historia e trazuar e Shqipërisë dhe pasojat e saj janë përgjegjëse për strukturat e papërshtatshme të (social) demokracisë. Këto janë të kushtëzuara kryesisht edhe nga mungesa e organizimeve të fuqishme sindikale, dobësitë e shoqërisë civile, lindjen e neoliberalizmit, problematikën e identitetit kombëtar, korrupsionin, performancën e dobët ekonomike dhe industriale (...)

Viti 2017 do të shënojë dy ngjarje që janë të rëndësishme për t'i kushtuar vëmendje: 100 vjetori i Revolucionit të Tetorit dhe 100 vjetori i lindjes së Musine Kokalarit. Kjo mund të jetë mundësia më e mirë për të reflektuar mbi teorinë, idetë dhe proceset. Edhe pse situata aktuale e Shqipërisë është e pakrahasueshme me atë të 1943-it, por po të faktorizohet, do të gjenden disa ngjashmëri, që kanë nevojë për një shans të ri. Prezenca e SHBA-së dhe BE-së është relativisht e fortë në vend, pasi Shqipëria synon anëtarësimin në BE në një të ardhme të afërt. Fatkeqësisht, politikat e vendit janë bllokuar për shkak të një konkurrimit të egër mes dy partive kryesore.

Duke sjellë në kujtesë përpjekjet e Kokalarit në formimin e një unioni demokratik, do të zbulojmë disa mësimë:

Musine Kokalari e përdori të drejtën e vetë-përcaktimit të saj politik, duke pranuar situatën e vendit dhe duke vendosur në perspektivë e duke sugjeruar çfarë duhet bërë në mënyrë që njerëzit të shijojnë drejtësinë sociale dhe politike. Kjo duhet bërë nga shqiptarët dhe jo vetëm nga "ekspertët e BE-së" apo ndonjë tjetër, përdërisa shqiptarët janë të vetmit që mund ti kuptojnë potencialet dhe mundësitë e vendit të tyre.

Edhe pse demokracia sociale nuk ka ndritur ndonjëherë në Republikën e Shqipërisë dhe nuk mund të presim që njerëzit e saj të jenë social demokratë, duke mësuar rreth themelimit të PSD në 1943in apo duke lexuar ndonjë broshurë, që shpjegon se çfarë është demokracia sociale, ne gjithsesi

mund të marrim shkas nga kjo pjesë e historisë së Shqipërisë dhe të rikonsiderojmë dhe të ri-ekzaminojmë shkaqet. Gjithsesi, mund të provohet se ka një traditë të social - demokracisë në vend, pavarësisht konotacioneve negative.

Siç thotë profesori i Harvardit, Frederik Logevall (2016) në mënyrë shumë të qartë: *“Kjo ka rëndësi... Njohja me të shkuarën tonë politike është e rëndësishme sepse mund të përdoret si antidot për shpërdorimin e historisë nga liderët tanë dhe na shpëton ne nga analogjitë mashtruese- nga eseja “Mësime nga e shkuara”- na bën ne më pak egocentrikë duke na vënë në dukje se si politikanë dhe qeveri në kohë të tjera i janë përgjigjur ndasive dhe sfidave. Dhe mund të na ndihmojë ne për të kuptuar më mirë efektet e mundshme të veprimeve tona, një hap vital në përvetësimin e ndërgjegjësimit dhe maturisë.”* Historia e Musine Kokalarit është një pikënisje e mirë për një kornizë të re teorike dhe diskutimi mbi social - demokracinë e cila mund të përfshijë aktorë të ndryshëm të shoqërisë. Në një botë në ndryshim, a nuk bashkëpunoi ajo me grupe të interesit, besimi i të cilëve nuk përkonte me të sajat? A nuk është ky thelbi i drejtësisë sociale?

## Referenca

- *Bashkimi Demokratik Shqiptar 1946. Akte gjyqësore politike gjatë komunizmit në Shqipëri 1. Dosjerë dhe dëshmi.* 2015. Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit. Prepared by Leka Ndoja. Tirana.
- Barbullushi, Odeta. 2014. *Albanian Political Parties, Inter-Party Relations and the EU.* EU integration and party politics in the Balkans. European Policy Center. EPC Issue Paper No. 77. Edited by Corina Stratulat. Pp. 83-94. Retrieved: August 27, 2016 ([http://www.epc.eu/documents/uploads/pub\\_4716\\_eu\\_integration\\_and\\_party\\_politics\\_in\\_the\\_balkans.pdf](http://www.epc.eu/documents/uploads/pub_4716_eu_integration_and_party_politics_in_the_balkans.pdf))
- Berman, Sheri. 2005. *Understanding Social Democracy.* Neë York. Retrieved: August 27, 2016 ([http://www.people.fas.harvard.edu/~ces/conferences/left/left\\_papers/berman.pdf](http://www.people.fas.harvard.edu/~ces/conferences/left/left_papers/berman.pdf))
- Bristow, William. Enlightenment. *The Stanford Encyclopedia of Philosophy* (Summer 2011 Edition). Edward N. Zalta. Retrieved: August 27, 2016 (<http://plato.stanford.edu/entries/enlightenment/>)
- *Dekalogu i organizatës nacionaliste Balli Kombëtar, 1942.* Brochure. Translated from the Albanian by Robert Elsie. Retrieved: August 27, 2016 ([http://www.albanianhistory.net/1942\\_BalliKombetar/index.html](http://www.albanianhistory.net/1942_BalliKombetar/index.html))
- Kokalari, Musine. 1972. *Si u formua Partia Social-Demokrate.* Edited by Platon Salim Kokalari (Tirana: Naim Frashëri 2000), and reprinted by Novruz Xh. Shehu (Tirana: Geer 2009). Pp. 403-436. Translated from the Albanian by Robert Elsie. Retrieved: August 27, 2016 ([http://www.albanianhistory.net/1972\\_Kokalari/index.html](http://www.albanianhistory.net/1972_Kokalari/index.html))
- Logevall, Frederik; Kenneth Osgood. 2016. *Why did we stop teaching Political History?* The New York Times.  
The Opinion Pages. Retrieved: August 30, 2016 (<http://www.nytimes.com/2016/08/29/opinion/ëhy-did-ëe-stop-teaching-political-history.html?ribbon-ad-idx=13&rref=opinion&mod>)

ule=ArrowsNav&contentCollection=Opinion&action=keypress&region=FixedLeft &pgtype=article)

- Nohlen, Dieter; Stöver, Philip. 2010. *Elections in Europe. A Data Handbook*. Nomos Verlagsgesellschaft. Pp.140-142
- Potthoff, Heinrich; Miller, Susanne. 2006. *The Social Democratic Party of Germany 1848-2005*. Bonn: Dietz Verlag.
- *Social democracy*. Encyclopaedia Britannica. Retrieved: August 26, 2016 (<https://www.britannica.com/topic/social-democracy>)
- Vickers, Miranda. 2014. *The Albanians. A Modern History*. London: I. B. Taurus.
- *What is Democracy?*. 2004. Lecture at Hilla University for Humanistic Studies. Retrieved: August 25, 2016 (<https://web.stanford.edu/~ldiamond/iraq/WhaIsDemocracy012004.htm>)
- Zhiti, Visar. 2012. *Amaneti i Musine Kokalarit*. Gazeta Shqiptare. Retrieved: August 27, 2016 (<http://www.peshkupauje.com/2012/02/amaneti-i-musine-kokalarit>)



## Appendix 1

### 6. Programi me dhjetë pika i Organizatës Kombëtare "Balli Kombëtar"

[Nga broshura: **Dekalogu i organizatës nacionaliste Balli Kombëtar, 1942**]

Organizata nacionaliste shqiptare *Balli Kombëtar*, e vendosur në linjën e vet të veprimeve, që kur u krijua (viti 1942) dhe që prej ditës fatkeqe të 7 Prillit 1939, ka mbledhur rreth vetes njerëz të nderit, që kanë vullnetin për të ndërmarë përgjegjësi për kombin dhe veten e tyre. Ne kemi publikuar tashmë objektivat dhe platformën tonë në broshura. Përveç kësaj ne dëshirojmë ta përsërisim edhe një herë që ne po punojmë dhe po luftojmë si më poshtë:

1. Ne luftojmë për flamurin kuq e zi, për mbrojtjen e të drejtave të Shqiptarëve.
2. Ne po luftojmë për demokraci, për një Shqipëri etnike dhe të lirë, për një shoqëri moderne.
3. Ne po luftojmë për një Shqipëri në të cilën liria e fjalës dhe mendimit do të mbizotërojë.
4. Ne po luftojmë për një Shqipëri me një balancë të sigurtë ekonomike dhe sociale në mënyrë që të mos ketë më shfrytëzues dhe të shfrytëzuar, me këtë duam të themi se askush nuk do të jetojë me shpenzimet e të rinjve, nuk do të ketë bujq pa tokë të mjaftueshme dhe nuk do të ketë më punëtorë me jakë të bardhë apo blu pa shtëpi e siguri, ne po luftojmë për një Shqipëri të qendrueshme me një sistem ekonomik të reformuar në përputhje me dëshirat dhe nevojat e njerëzve.
5. Ne po luftojmë për një Shqipëri, në të cilën talentet e humbura të të gjitha shtresave të popullsisë do të ndriçohen, do të mbështeten dhe do të lulëzojnë me ndihmën e shkollës shqiptare.
6. Ne po luftojmë për një Shqipëri, në të cilën të gjitha kontributet do të vlerësohen në mënyrë të drejtë, pavarësisht moshës, fesë apo besimit.
7. Ne po luftojmë të krijojmë një Shqipëri të drejtuar nga njerëz të pa kompromentuar, nga shqiptarë që kanë bërë ç'është e mundur në çdo

kohë dhe në kushte të vështira për çlirimin dhe mirëqenien e vendit të tyre, nga njerëz kompetentë dhe të ndershëm.

8. Ne po luftojmë për një Shqipëri, që në një mënyrë strikte dhe të pashoqe, do të ndëshkojë të gjithë tradhëtarët, servilët, ngatërrestarët, spekulatorët dhe spiunët; për një Shqipëri, në të cilën nuk do të ketë vend për hipokritë, lajkatarë, feudalë dhe për askënd që pengon zhvillimin dhe progresin e vendit tonë rilindas.
9. Ne po luftojmë për të harmonizuar dhe bashkuar energjitë krijuese të kombit, për të krijuar një bashkim intelektual dhe shpirtëror të shqiptarëve.
10. Ne po luftojmë për të mobilizuar gjithë forcat vitale të kombit, kundër pushtuesve në mënyrë që të realizojmë idetë e Ballit Kombëtar.

## Appendix 2

### 7. Programi i Partisë Social Demokrate

#### Publikuar në gazetën “Zëri i Lirisë”, Tiranë, 1 Shkurt 1944

1. Një objektive e rëndësishme e Partisë Social – Demokrate është, të sigurojë drejtësinë sociale dhe lirinë politike.
2. Partia Social - Demokrate ndërmerr një qëndrim evolucionist përsa i përket kolektivizmit ekonomik.
3. Objektiva të tjera kryesore të Partisë janë të sigurojë mjaftueshëm tokë për bujqit që të punojnë dhe të eliminojmë shfrytëzimin, spekulimin dhe parazitizmin. Ka për qëllim, gjithashtu, të mundësojë ushqim, strehë dhe nevoja të tjera për klasën punëtore, për t'i bërë jetët e tyre të jetueshme. Për reformën agrare – hapat fillestarë do të jenë ato të ndarjes së tokës. Partia do të përpiqet të mundësojë dhe implementojë skemën e sigurimit social dhe të mbrojë të gjitha klasat e shoqërisë.
4. Liri politike do të thotë sigurimi i të drejtës për çdo qytetar, të drejtës së fjalës, lirinë e mendimit, lirinë e shtypit, lirinë për iniciativa private dhe liri vote (opozitë parlamentare). Partia do të përpiqet të vendosë themelet e kontributit për edukimin e të gjithë klasave të shoqërisë Shqiptare dhe t'i përgatisë ata për regjimet e tjera që do të vinë, në të cilat do të mbretërojnë drejtësia sociale dhe liria politike. Arsyeja kryesore që kufizon lirinë politike është [mungesa e] drejtësisë sociale.
5. Në lidhje me marrëdhëniet me kombet e tjera, Partia nuk do të drejtohet nga një nacionalizëm i ngushtë e egocentric, por nga patriotë të thjeshtë, që përshaten me ndjenjat e respektit dhe afeksionit me kombet e tjera, dhe do të mbrojmë idenë e krijimit të një konfederate Ballkanike sa më shpejt të jetë e mundur.
6. Një objektiv tjetër i Partisë është lufta kundër të gjithë pushtuesve për pavarësinë e një Shqipërie të bashkuar brenda kufijve të saj etnikë.
7. [Përmbledhje nga: Si u formua Partia Social-Demokrate. Punuar nga Platon Salim Kokalari 9Tirana: Naim Frashëri 2000) dhe e ribotuar nga Novruz Xh. Shehu (Tiranë, Geer 2009), fq. 403-436.]





## Appendix 3

Tiranë Mars 1945

### 8. "Organizata Kombëtare e Legalitetit"<sup>2</sup>

#### 2.10 [Memorandumi i Bashkimit Demokratik drejtuar Aleatëve.]<sup>3</sup>

Gjatë pushtimit italian dhe gjerman në Shqipëri, komunistët luftuan kundër forcave pushtuese nën zërin e "Frontit Nacional Çlirimtar", programi politik i të cilit bazohej tërësisht në një sistem demokratik. Një thirrje kaq gjeniale u dha mundësinë të zgjerojnë në mënyrë të konsiderueshme radhët e tyre, duke regjistruar një pjesë të madhe të djemve, të cilët luftonin me gëzim për çlirimin e atdheut. Arsyeja, që një pjesë e madhe e djalërisë u bashkua me komunistët, qëndron në faktin që dy grupet e tjera nacionaliste (Balli Kombëtar dhe pasuesit e Zogut), duke patur frikë nga komunizmi dhe duke qenë nën influencë të një pjese të shtypit Aleat, nuk vazhduan luftën kundër forcave pushtuese. Djalërisë dhe nacionalistëve të tjerë, që morën pjesë në Lëvizjen Nacional Çlirimtare, nuk u shkoi ndërmend kurrë se po binin në grackë dhe të mendonin ngritjen me forcë të një regjimi komunist në Shqipëri.

Në këtë mënyrë Fronti Nacional Çlirimtar u bë i vetmi grupim politik i autorizuar nën direktivat dhe kontrollin komunist. Nacionalistët, që përbënin shumicën, nuk lejohen të formojnë një parti të veçantë nga komunistët; ata nuk lejohen, gjithashtu, të shkëputen prej frontit duke krijuar një parti jashtë tij. Në të dy rastet akuzohen si sabotatorë, fashista dhe reaksionarë „rasti i prof. Gjergj Kokoshit, më parë ministër i Arsimit në qeverinë e Enver Hoxhës e tregon qartë këtë gjë.“

<sup>2</sup> Disa raporte të tjera drejtuar Misionit Britanik janë arkivuar në dosjen 1081 F.1, të AMBR, në zërin hetimor të ing. Abdulla Muçës. Kopjet origjinale të Memorandumit të Partisë Monarkiste fillimisht dhe të organizatës Bashkimi Demokratik, pas shkrirjes së grupeve më 20 nëntor 1945, u përkthyen në gjuhën angleze dhe i dorëzoheshin Misionit Britanik në mënyrë të fshehtë apo të drejtpërdrejtë. Memorandum i monarkistëve (kopje e kapur prej Sigurimit), sipas pohimit të Enver Hasës në hetuesi, është përkthyer nga ky në italisht dhe mandej në Anglisht nga oficeri italian, Bici.

<sup>3</sup> Memorandum i nuk mban as kokë e as datë, por në fq.2 thekson se "Shqipëria ndodhet për 13 muaj nën diktaturë..." para zgjedhjeve të 2 dhjetorit, dmth bëhej fjalë për fundin e muajit nëntor 1945, [teksti i memorandumit i shkruar nga Musine Kokalari, në mbledhjen e BDSH, në shtëpinë e Ali Kavajës].

## 2. Pasqyra e përgjithshme e gjendjes së tanishme.

(a) Kryesia e Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar, qeveria, këshillat e Prefekturave dhe të nënprefekturave, si dhe të lokaliteteve më të vogla, ndodhen të gjitha nën drejtim dhe kontrollin komunist.

(b) Të trija fuqitë, dmth pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, ndarja e të cilave garanton një regjim me liri politike, në fakt janë një përzjerje. Shumëzimi i zyrave bëhet për këtë qëllim. Shembull është që kryetari i policisë, në të njëjtën kohë, gjendet edhe anëtar i trupit gjykues (nënpresident), anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, Kryetar i Gjyqit të Lartë, Kryetar i Komisarëve Politikë në ushtri etj.

(c) Të katër liritë (liria e fjalës, e fesë, e nevojës dhe e frikës) janë shkelur nën këmbë.

(d) I tërë legjislacioni është marrë prej atij të Jugosllavisë; ligjet më të rëndësishme janë një përkthim besnik i ligjeve Jugosllave.

(e) Në të gjitha problemet shtypi ynë dhe radio paraqesin tërësisht pikëpamjet ruse.

(f) Puna e Policisë bëhet prej Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit, programi dhe aktiviteti i së cilës përbën një GPU të dytë. Kryetari i saj Gjeneral, Koci Xoxe, është një nga të dy sekretarët e përgjithshëm të Partisë Komuniste Shqiptare, tjetri është vetë Enver Hoxha.

(g) Numri i atyre që janë varur egërsisht gjatë ditëve të para të regjimit (150 pa u gjykuar fare në Tiranë e në rrethe), si dhe ata që janë gjykuar, dënuar me vdekje dhe pastaj ekzekutuar, i kapërçen të 1.000-jën në të gjithë vendin. Në qoftë se merr si shembull Francën, popullata e së cilës është 45 herë më e madhe se e jona, që në të njëjtën kohë, numëron 2.321 dënime me vdekje, atëherë mund të kuptonit tragjedinë e popullit shqiptar. Shumë prej këtyre janë ekzekutuar për shkak se po të qenë të gjallë do të kanosnin unitetin e regjimit të tanishëm.

Ka rëndësi këtu të përmendet që, ca muaj më parë në Durrës, disa njerëz i bënë qeverisë një telegram me anën e të cilit kërkonin mëshirë për ca persona, që u dënuan me vdekje nga gjyqi lokal. Për këtë ata u arrestuan menjëherë, u nxorën në gjyq dhe u dënuan me burgim pasi me qëndrimin e tyre kishin shkuar kundër mendimit gjyqësor, i cili konsiderohet si shprehje më e lartë e vullnetit të popullit! Aktiviteti i Mbrojtjes së Popullit dhe mënyra me të cilën u zhvillua drejtësia kanë krijuar një atmosferë frike dhe

terrori në të gjithë vendin. Natyrisht, kjo gjë e ka shtuar më tepër numrin e të pakënaqurve, por frika dhe vetëm frika i ka ndaluar ata të organizohen në një opozitë.

Po të mos dish këtë gjë të nëndheshme është e pamundur të marrës vesh pse populli do të shkojë në votime më 2 dhejtor, si mund të bëhej ndryshe, kurse Shqipëria ndodhej për 13 muaj nën diktaturën më të tmerrshme që ka parë historia e saj. Shko në katunde dhe bisedo me popullin fshehtësisht dhe atëherë do të konstatosh se një presion është ushtruar në favor të listës unike të Frontit Nacional Çlirimtar.

(h) Shqipëria nuk ka patur kurrë një ushtri kaq të madhe sa kjo e tanishmja; numri i saj është dyfishuar qysh prej çlirimit të vendit dhe tani përbëhet prej rreth 60.000. Mbajtja e një ushtrie kaq të madhe i kushtohet kryesisht faktit se autoritetet kanë frikë që numri i vazhduar i të pakënaqurve mund të përbëjë rrezik për regjimin. Kjo masë politike ka patur një efekt katastrofal jo vetëm për financat tona, që përmbledhin më tepër së gjysmën e buxhetit për ushtrinë, po gjithashtu edhe për bujqësinë dhe blektorinë, në të cilat ndihet seriozisht mungesa e krahut të punës.

(i) Në administratat tona gjenden gati katër herë më shumë funksionare se përpara. Kjo i përgjigjet faktit se qeveria mund t'iu gjejë punë të gjithë punonjësve besnikë pa marrë parasysh kapacitetin e tyre. Me gjithë atë, për të patur një administratë të kënaqëshme, ata janë të detyruar të mbajnë disa nga teknikët më të mirë dhe, në fakt, janë këta që bëjnë gjithë punën. Por kjo situatë ka krijuar njëfarë kaosi dhe, për këtë, kjo është arsyeja që nëpër krahina punët zgjaten tepër.

(j) Ligji i bujqësisë është nga reformat më me rëndësi, për të cilën regjimi fryhet së lëvduari. Kjo është bërë dhe aplikuar në mënyrë ekstreme:

1/ Toka, që u është lënë pronarëve të mëparshëm (15 hektarë), është e pamjaftueshme t'iu sigurojë atyre jetën megjithëse kanë mjaft tokë për të gjithë.  
2/ Ligji bujqësor, kështu siç ekziston, është vetëm e vetëm një konfiskim, pasi e tërë toka është shpronësuar, duke mos u shpërblyer aspak.

(k) Qeveria e ka humbur besimin e tregtarëve për shkak të masave që kanë ndër degët e ndryshme të aktivitetit ekonomik. Iniciativa private është zhdukur pothuajse krejtësisht.

(l) Përsa i përket politikës së jashtme, qeveria e tanishme i qëndron besnike aksit Beograd – Moskë. Parulla “Enver – Tito” është bërë e zakonshme.

### 3. Kush jemi ne?

Është nevoja të theksojmë që ne nuk jemi armiq të e komunizmit. Edhe sikur të mos ekzistonte komunizmi do të qe e dobishme ta krijonim si një fuqi shtytëse drejt përparimit social. Por, nga ana tjetër, ne jemi kundërshtarët e tij politikë deri sa ai shkel liritë politike dhe ngre një qeveri despotike në vend të asaj demokratike.

### 4. A është e mundur demokracia në Shqipëri?

Është e parakohëshme të flitet në Shqipëri për një demokraci të tipit perëndimor. Po, nga ana tjetër, kjo nuk do të thotë se është nevoja për një qeveri totalitare në vendin tonë. Ne besojme se një demokraci relative me të paktën 2 parti është plotësisht e mundëshme në Shqipëri. Kjo gjë do ti jepte rast shumicës së popullit, të cilët nuk janë komunistë të bashkohen me një organizatë, me anën e së cilës të jenë në gjendje të shprehin idetë politike.

### 5. Cili është programi ynë?

#### (a) Politika e brendshme

Vendosja e menjëherëshme e lirisë së plotë politike. Liri e fesë, liri e shtypit, liri e personave dhe mbrojtja përpara ligjit dhe përpara gjyqit me gjykatës të zgjedhur.

#### (b) Politika e Jashtme.

Pjesëmarrja në të gjithë kombet e bashkuara në themelimin e një rregulli internacionalist të bazuar mbi principin e sigurimit kolektiv. Mbajtja e marrëdhënieve miqësore me të gjithë aleatët tanë të mëdhenj dhe me të gjithë fqinjët tanë. Ne do të përpiqemi me të gjitha forcat tona për të dhënë kontributin tonë për një të ardhme paqësore dhe më të mirë në Ballkan dhe të sigurojmë integritetin tonë tokësor, konform shpirtit dhe Kartës së Atlantikut.

#### (c) Politika Sociale

Përmirësimi material dhe moral i kushteve të jetës së klasës punëtore. Pjesëmarrja e plotë e punëtorëve dhe e fshatarëve në jetën politike. Lenia e lirë e organizatave të punëtorëve dhe pjesëmarrja e tyre në vendosjen e kushteve të punës. Demokratizimi i institucioneve. Rivendosja e identitetit familjar.

**(d) Politika Ekonomike**

Respektimi i plotë i pasurive private brenda kufijve të funksioneve shoqërore. Kontrolli i shtetit mbi industritë vitale dhe inkurajimi i iniciativës dhe i ndërmarrjeve private.

Reforma agrare

Ngritja e shtëpive moderne për fshatarësinë dhe krijimi i kooperativave bujqësore.

**6. Dëshira jonë e zjarrtë**

Duke konsideruar që misioni juaj në Shqipëri është i shenjtë, pasi e keni për detyrë t'i thoni botës situatën e vërtetë të vendit tonë, shpresojmë se do të konstatooni që në situatën e tanishme të flasësh për zgjedhje të lira do të thotë të errësosh të vërtetën. Me këtë frymë, ne shpresojmë që ju do të bëheni interpret jo vetëm i opozitës, por pothuaj i dëshirës së gjithë kombit për shtyrjen e zgjedhjeve, në mënyrë që t'i jepet rast popullit të shprehë lirisht vullnetin e tij dhe në këtë mënyrë të ngrejë një qeveri demokratike përfaqësuese.

Do të shihni një numër të madh realizimesh që do t'ju tregohen për llogari të qeverisë të tanishme. Ne nuk e vëmë në dyshim vullnetin e mirë të qeverisë, por, në të njëjtën kohë, e quajmë të nevojshme të nënvizojmë që shumica e këtyre realizimeve kanë ekzistuar përpara Nëntorit të 1944-ës. Përsa u përket urave dhe punimeve të tjera të këtij lloji, çdo shqiptar e di mirë që këto janë ndërtuar prej shoqërive italiane, nën mbikqyrjen shqiptare, me materiale të sjella nga Italia.

**PS: LUTEM, ZHDUKNI KËTË RAPORT MENJËHERË PORSA TA KENI LEXUAR, NË QOFTË SE POLICIA OSE ÇDO SPIUN DO TË MARRË VESH KËTË GJË, JETA JONË ËSHTË NË RREZIK.**

[Memorandumi është marë nga: Bashkimi Demokratik Shqiptar 1946]



## Appendix 4

### Fragment nga gjyqi i Kokalarit

Marrja në pyetje filloi. U pyeta për Shënimin. Ata kishin folur më parë me njerëz të tjerë para meje, por këta të fundit nuk kishin mundur të mbronin mjaftueshëm veten e tyre.

Unë fillova si më poshtë: “Ne formulua Shënimin në emër të tre grupeve për t’ia nisur Aleatëve, të cilët ju i lejuat të monitoronin votat, pasi supozohej se do të ishin demokratike. Ne e bëmë këtë në mënyrë që një koalicion demokratik, me një platformë të ndryshme të mund të prezantonte kandidatët e saj dhe kështu mund të merrnim pjesë në zgjedhje, nëse ato do të shtyheshin për ca kohë.”

“Interesante” u përgjigj Nesti Kerenxhi, i cili ishte shefi i Sigurimit. “Ti vjen nga një familje demokratike, anti-Zogiste, si ndodhi që u bashkove me këta monarkistë?”

“Këtë mësim e mësova prej jush”, u përgjigja. “Njerëzit tuaj janë komunistë dhe Partia Komuniste udhëheq Frontin, por gjithsesi, ju iu bashkuat forcave të Bazit të Canës, të cilat njiheshin për përfaqësimin e Ahmet Zogut.”

Ata nuk reagueshan, të pasigurtë në atë që duhej të thoshin.

“Ju u përpoqët të rrëzonit qeverinë,” deklaruan ata.

“Jo, ne kërkua shtyrje të zgjedhjeve. Unë nuk kisha ndonjë grupim pas meje, thjesht dy burra. Si mund ta rrëzonim ne qeverinë?”

“Ju po përdornit klasën udhëheqëse, duke shfrytëzuar fuqinë e tyre për të marrë drejtimin,” kundërshtuan ata.

“Kjo nuk është e vërtetë. Unë as nuk e dija se çfarë fuqie kishin ata. Po nëse ata do të kishin shumë fuqi? Nëse ata nuk arritën dot t’ju eliminonin kur Gjermanët ishin këtu, si mund ta bënin ata tani këtë gjë?”

“Ata gjithashtu ishin pas tezës së shtyrjes.”

“Unë jam e përgjegjshme vetëm për ato që them vetë. Unë nuk mund të mbahem si përgjegjëse për objektivat e njerëzve të tjerë. Nëse ata do të ishin të aftë të rrëzonin qeverinë në pushtet, të jeni të sigurtë që do të na i fshinin idetë tona nga koka e nga toka.”



“Pse nuk ja nisët Shënimin qeverisë?” pyetën ata. “Ne nuk do t’ju arrestonim.”

“Ne nuk mund ta bënim këtë. Nëse do t’ia nisnim Shënimin qeverisë, njerëzit do të ishin ankuar, do të kishin parapërgatitur çdo gjë me komunistët dhe ata do të merrnin vesh se kush ishte pas këtij grupimi. Të gjitha grupimet dhe programet e tyre do të bëheshin publike menjëherë. Nëse ata do të fitonin zgjedhjet, në rregull, por, nëse do të humbnin, gjërat do të merrnin fund. Nëpërmjet Shënimit, ne donim që forcat Aleate të merrnin një qëndrim. Ne ua nisëm atyre Shënimin me shpresën se ata do të bënin të njohur faktin se: “Ka disa grupime në Shqipëri, që duan të marrin pjesë në zgjedhje. Këto zgjedhje duhet të jenë të lira. Çdokush duhet të lejohet të marrë pjesë. Por ata nuk e bëjnë këtë dhe tani unë kam detyrën e vështirë të justifikoj përmbajtjen e Shënimit.”

“Ju ishit duke mbjellë farat e përçarjes.”

“Absolutisht jo. Ne nuk drejtoheshim nga elementë të Frontit. Më tregoni një njeri, që do të vërtetojë se ishim duke krijuar trazira! Ne donim që Fronti të drejtohej nga një parti, Partia Komuniste, apo Partia Social-Demokrate, apo ndonjë tjetër.”

“Ne ishim ata që po bënim luftën,” thanë ata.

“Kështu bënim dhe ne. Ndoshta jo me armë, por në forma të tjera. Ne nuk bashkëpunuam me pushtuesit. Ju e dini shumë mirë se unë nuk kam bërë asgjë kundër jush, dhe as nuk kam bashkëpunuar kurrë me pushtuesit. Ju do të më dënioni mua jo sepse jam e fajshme, apo ku e di unë çfarë, por sepse ju komunistët nuk do të lejoni parti të tjera dhe për të justifikuar këtë ju pretendoni se ne po përpiqeshim të rrëzonim qeverinë. Unë jam e pafajshme. Unë nuk jam komuniste dhe kjo në vetvete përbën një krim. Ju i fituat zgjedhjet dhe unë përfundova në burg. Ju më arrestuat dhe thatë që jam fajtores. Unë nuk e pranoj këtë.”

“A donit ju të kishit mundësi të botonit diçka?” thanë ata.

“Po,” iu përgjigja.

“Por kush mund të kishte bashkëpunuar me ju për këto botime?”

“Çfarë pyetje e kotë. A nuk jemi ne të zotët të printojmë një gazetë? Nëse

do të kishim fituar, do të botonim një gazetë në të cilën njerëzit do të shprehnin opinionet e tyre. Atëherë do ta shihnit se kush do të shkruante. Ju nuk keni deklaruar kurrë se gjithëkush duhet të jetë komunist. Ju thatë se do të mbronit shtypin e lirë.”

“Dhe ju mbroni shtypin fashist?”

“Unë nuk jam fashiste. Unë kam kulturë demokratike. Unë jam ndjekëse e të nderuarit Sami Frashëri. Unë nuk jam komuniste. Është diçka që unë nuk e kuptoj.”

„Le ta mbyllim këtë gjë. Nëse do t’ja kishit nisur Shënimin qeverisë, ju nuk do të ishit arrestuar. A nuk e menduat ndonjëherë se mund të përfundonit në burg?”

“Jam shumë e bindur për këtë. Por të paktën e di se përse jam në burg. Nëse jam dënuar gabimisht, edhe këtë do ta di.”

Unë e mbroj pozicionimin tim dhe me shkrim.

Prokurori i shtetit, Gjon Banushi dhe gjyqtari Frederik Nosi, e përsëritën akuzën e tyre gjatë gjyqit të mbajtur në Gjykatën e Lartë dhe unë i mbroj idetë e mia deri në fund.

Gjyqi i Posatshëm filloi në 2 Qershor. Kryetari i trupit gjykues ishte Frederik Nosi dhe prokurori i shtetit ishte Nefzat Hasnedari. Ata filluan me grupin e Sami Çeribashit, më pas, me monarkistët dhe më në fund me mua. Gjykatësi pyeti:

“Kush e shkroi Shënimin?”

“E bëri Musine,” thanë ata.

“A është e vërtetë Musine?”

“Po,” iu përgjigja unë.

“Kush i shtoi emrat e tjerë?”

“Musine,” u përgjigjën ata.

“A është e vërtetë?” pyetën ata.

“Po,” iu përgjigja, “Unë shtova të gjithë emrat e të gjithë grupimeve që donin të merrnin pjesë me platformat e tyre politike.”

“Por kishte nga katër veta për çdo grup, atëherë përse e bëre tërë këtë punë e vetme?” pyeti gjykatësi.

“Katër ishin mjaftueshëm për çdo grup. Por sa më pak të ishim, aq më pak do të përfundonim në burg. Por të gjithë ishin të lirë të merrnin pjesë.”

Dita e vlerësimit erdhi, dhe unë e gjeta veten në bankën e të pandehurit. Unë iu afrova mikrofonit. Gjykatësi Frederik Nosi më pyeti:

„A i pranon akuzat?“

“Bazuar në logjikën tuaj politike, po. Por sipas meje, jo.“

„Mjaft me sofizmin tuaj!“ bërtiti Frederik Nosi.

„Atëherë nuk ka kuptim të më pyesni. Lexoni dokumentet e gjyqit,“ theksova, e kënaqur me veten dhe u ula në vendin tim.

Argumentet përfundimtarë ishin shumë të ashpër. Gjithçka që ishte diskutuar, u përdor si kundërgument ndaj meje. Mendova se do të më dënonin me vdekje. Si përfundim prokurori më akuzoi mua për mëkatet e gjithë të tjerëve. Unë nuk bëra asnjë koment.

Erdhi dita që të akuzuarit të mbronin veten e tyre. Unë e refuzova mbrojtësin dhe përgatita mbrojtjen time. Ata nuk e kishin idenë se çfarë po bënin. Prokurori më akuzoi se kisha krijuar një grup për të rrëzuar qeverinë dhe deklaroi për mua një dënim me tridhjetë vjet burgim. Me fjalimin në dorën time, ju afrova mikrofonit dhe fillova të lexoj si më poshtë: „Janë tridhjetë e gjashtë veta të akuzuar këtu, në këtë gjyq. Katër grupe, tre prej të cilëve kanë vetëm një gjë të përbashkët – Një Shënim të nisur Aleatëve për të shtyrë zgjedhjet në mënyrë që një koalicion demokratik të merrte pjesë në to. Nuk ka pasur asnjë synim për rrëzim të qeverisë. Ishte thjesht për të patur zgjedhje demokratike.“

Të dy, gjykatësi dhe prokurori u çuan në këmbë dhe më ndërprejnë.

„Ne nuk do t’ju lejojmë të vazhdoni me këtë mbrojtje.“

“Nëse do më ndaloni dhe nuk do lejoni një të burgosur të mbrojë veten, atëherë unë do të ulem, pasi nuk kam zgjidhje tjetër,” thashë unë.

U ktheva në vendin tim. Shumë shkurt, pas kësaj, oficer Manoli u afrova dhe më konfiskoi dokumentin e mbrojtjes sime. Unë nuk refuzova. Ata më

pyetën për një fjalë të fundit. Unë kërkova drejtësi. Gjyqi zgjati 15 ditë. Në fund, gjykatësi dha dënimin për njëzet vjet dhe unë isha e burgosur. [...]

[Përmbledhje nga: Si u formua Partia Social-Demokrate. Punuar nga Salim Kokalari (Tiranë, Naim Frashëri 2000) dhe e ribotuar nga Novruz Xh. Shehu (Tiranë: geer 2009), fq. 403-436]